



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/2020

Datë: 09.07.2020

Procesverbal

i mbledhjes se IV (e katërt) të rregullt për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/112 datë:11.06.2020, të parashtruar nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore të Komunës së Malishevës 2021-2023.
2. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimit të mjeteve për COVID-19.
3. Shqyrtimi i kërkesës nr.04/113 datë:11.06.2020 për lirim të subjekteve afariste nga taksa komunale e ushtrimit të veprimtarisë për vitin fiskal 2020.
4. Shqyrtimi i kërkesave.
5. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 19.06.2020 duke filluar në ora 13:00, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, zyra për informim, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Valon Mazreku.

Rrahim Morina: Ju përshëndes kuorum për mbledhje kemi, për disa pika nuk kemi material. Kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/112 datë:11.06.2020, të parashtruar nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore të Komunës së Malishevës 2021-2023.

Alban Krasniqi: Tani lidhur me këtë pikë mungon drejtori i Financave dhe kryetari i Komunës, sepse është obligative me sqaru këtu në çfarë tregues janë bazuar për KAB-in, cilat janë elementet e nivelit qendror dhe lokal, cilat planifikime i keni futur për vitin 2021.

Valon Mazreku: Në bazë të qarkores buxhetore të kategorisë paga është aktualja, aty ku ka ndryshime janë kërkuar 30 vende punë në shëndetësi pasi që atje tani është afër lëshimi i emergjencës objekti i ri. Te Subvencionet kemi kërkuar të rriten në 400 mijë euro, pastaj edhe për pagesat për nënat lehonat se deri tani kemi pas problem në ekzekutim të atyre mjeteve.

Hashim Vrenezi: A parashihet zvogëlim i buxhetit për vitin 2021 pasi që këtu thuhet se ka mu rritje numri i punëtorëve.

Valon Mazreku: Numri i mësimdhënësve në arsim dhe granti aty ndahen në bazë të numrit të nxënësve, por thuhet se numri i nxënësve shkon duke u zvogëluar. Kufijtë tjerë s'janë përcaktues mund të ndryshojnë.

Alban Krasniqi: Ndërtimi i çerdhës në Kijevë dhe numri i punëtorëve a është dashtë të futen në kornizë pra të planifikohet.

Valon Mazreku: Unë secilës drejtori ja kam dërgua qarkoren buxhetore.

Hashim Vrenezi: Çka është kërkuar prej nivelit qendror, a keni të drejtë me ba ndryshim ose një analizë e kur ta aprovojne ma na qu neve qysh neve na konvenon në bazë të nevojave tona që ta bëjmë një buxhet si na duhet.

Valon Mazreku: Buxheti i nivelit lokal në kategori me dashtë me rrite, duhet një komunë tjetër me ulë tavanin e atij zëri ku planifikon një komunë me rritur.

Rrahim Morina: A jeni qe ta rekomandojmë për kuvend këtë pikë? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimit të mjeteve për COVIC-19.

Rrahim Morina: Për këtë pikë janë vonuar ekzekutivi për material, ne tani e morëm një pjesë të materialit nga zyra e Kryetarit të Komunës, ky material përfshinë edhe donacionet e dhëna gjatë pandemisë.

Muharrem Morina: Ky raport i shpenzimeve është qysh kur a paraqitur rasti i parë me Covid.

Alban Krasniqi: Në për raportin e shpenzimeve tani kemi dy materiale në formë tabelare, pastaj si shpenzim i shtabit emergjent a futur furnizim me pije dhe ushqim. Sa njerëz kanë kujdestaruar pas parasysh qe kujdestarinë dikush e ka detyrë, e sidomos kur puna behët gjatë orarit të punës pse mu krijuar këto shpenzime pra nuk ka pas nevojë me kanë këto shpenzime. Kuvendi kur i ka nda ato mjete janë kanë disa kategori nuk kemi nda mjetë për pijë e ushqim. Për këtë pikë në kuvend të kemi kategorizimin e gjitha shpenzimeve. Kërkesat sipas atij vendimi kanë qenë të kategorizuara, duhet të dimë sa mjetë janë shpenzuar, sa kanë mbetur pa shpenzuar, sepse ka ndoshta shpenzim që ne se kemi votuar. Ka vendim për miell po a kanë shkuar me procedura të prokurimit, dezinfektimi që po bëhet për rriqra pse te futet në këtë raport, ne vende tjera vendosja e kabinës dezinfektuese është bërë shumë me lire se në Malishevë, unë dy herë kam qenë dhe nuk e kam pa se ka punuar ajo kabinë të ambolanta, mirë është me ditë pse ka kushtuar kaq shpejtë kjo kabinë, ose çfarë lloji të stafit shtesë ka angazhuar Komuna në shëndetësi, çfarë funksioni kanë kryer ata punëtorë dhe a ka pas njoftim publik kur janë marrë me punu dhe a janë ende duke punuar. Për dezinfektim janë ndarë 15.000 euro e këtu në raport janë mbi 20.000 euro te cekura.

Drejtori i Financave Valon Mazreku: Mjetet e kuvendit janë me një kod të krijuar nga Mef-i dhe krejt ato shpenzime janë në atë kod, ka ende në procedurë por ato çka janë shpenzuar kanë shkuar përmes procedurave.

Alban Krasniqi: Në raport i keni futur edhe shpenzimet për barna e që ka pas tejkalim të shpenzimeve po ashtu kërkoj informacion në cilët vende keni bërë dezinfektime.

Valon Mazreku: Këto shpenzime të cekura janë nga ky kod.

Hashim Vrenezi: Ky raport është tabelar, por mirë është të dimë se këto shpenzime a janë bërë me procedura të prokurimit ose në çfarë forme, pse keni angazhuar staf shtesë në shëndetësi.

Valon Mazreku; Krejt kanë shkuar me procedurë te negocimit.

Hashim Vrenezi: Pse ka shpenzime për ushqim e pije për shtabin emergjent ne orar të punës, dhe nëse kanë punuar natën çfarë punë kanë bërë.

Alban Krasniqi: Nëse ka pas donator që ceken në raport mirë është me pa listën e donatorëve, te dihen familjet kush janë ndihmuar me të holla. Nga gjitha këto pyetje për mbledhje kërkojmë këto inflacione.

- Sa mjete janë shpenzuar sa i përket shëndetësisë, për çka janë shpenzuar dhe sa mjete kanë mbetur të pa shpenzuar ne kuadër të vendimit për ndarjen e mjeteve për COVID-19
- Të sillen kontratat për secilin furnitor , secilin furnizim gjatë kohës së pandemisë
- Të specifikohet vendimi për 20.000 euro për furnizim me barna
- Informacion lidhur me kontratat e dezinfektimit përfshirë kabinën dezinfektuese
- Informacion lidhur me kontratën për pakot ushqimore dhe higjienike.
- Informacion lidhur me kontratat në vepër në QKMF, lloji i shërbimit që kryejnë dhe kohëzgjatja e kontratës.

Rrahim Morina: Kush jeni me rekomanduar këtë raport për Kuvend? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi i kërkesës nr.04/113 datë:11.06.2020 për lirim të subjekteve afariste nga taksa komunale e ushtrimit të veprimtarisë për vitin fiskal 2020.

Rrahim Morina: Cilat subjekte do të lirohen pasi që tash e kemi edhe rregulloren për Taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale ende pa miratuar.

Alban Krasniqi: Jo veç bizneset por edhe shërbime që i kryejnë qytetaret te shqyrtohen ndoshta edhe te lirohen nga ngarkesat por jo veç bizneseve.

Hashim Vrenezi: Jemi mi liru bizneset por sa janë të hyrat e planifikuara nga kjo kategori që doni mi liru bizneset. Unë për këtë pikë propozoj të sillen borxhet ndër vite sa janë, ose ndoshta a kanë mirë me nxjerr vendim që bizneset që paguajnë deri në 50% e totalit borxhit tu falët për pjesën tjetër.

Valon Mazreku: Kjo është e vështirë mu ba sepse ka dikush që ka hap biznes vetëm sa për me marrë një vizë.

Hashim Vrenezi: Cilat masa i keni marrë si komunë me rrite inkasimin.

Rrahim Morina: Kush jeni me rekomanduar këtë pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.09/73 datë: 17.06.2020 të parashtruar nga Shoqata e Kompanive Transportuese në Malishevë.

Hashim Vrenezi: Si kërkesë nuk po me duket e pa arsyeshme, por nuk ka asnjë nënshkrim, gjendja ka qenë emergjente kompanitë nuk kanë mundur më punuar.

Alban Krasniqi: Kur themi biznese edhe këto kompani janë pjesë e bizneseve, por njëherë para se me shqyrtua duhet me pa sa kanë paguar këto kompani.

Rrahim Morina: Ne po i kërkojmë Drejtorisë për Shërbime Publike informacione lidhur me obligimet e kryera financiare ndaj Komunës nga këto kompani për vitin 2019 dhe cilat kompani janë të përfshira në kryerjen e këtyre obligimeve-pagesave. Sa janë detyrimet e planifikuara për kompanitë e transportit për vitin 2020.

Unanimisht kërkohet informacion për këtë kërkesë nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Kërkesa nr.02/159 datë:21.05.2020 të parashtruar nga kryetari i fshatit Mirushë

Kërkesa nr.02/148 datë: 18.05.2020 të parashtruar nga kryesia e fshatit Carrallukë

Kërkesa nr.01/158 datë: 21.05.2020 të parashtruar nga kryesia e fshatit Terpezë e Poshtme.

Kërkesa nr.09/185 datë: 10.06.2020 të parashtruar nga kryesia e fshatit Kijevë

Alban Krasniqi: Lidhur me kërkesën e fshatit Carrallukë ura që a cek në kërkesë po ashtu edhe kanalizimi në Terpezë të dyja duhet të trajtohen me urgjencë.

Hashim Vrenezi: T'i përcillen këto kërkesa drejtorisë për Urbanizëm të dalin në teren të bëjnë analiza dhe paramasa.

Rrahim Morina: Pas shqyrtimit të këtyre kërkesave, Komiteti për Politikë dhe Financa përmes kësaj shkrësë përcjellëse kërkon prej Drejtorisë për Urbanizëm që t'i trajtoje kërkesat e lartcekura, te dal në teren t'i dhe brenda mundësive buxhetore të bëjë paramasat dhe parallogarite dhe të intervenoj sipas prioriteteve.

Rrahim Morina: Kush jeni që këto kërkesa t'i përcillen Drejtorisë për urbanizëm për trajtim? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/84 datë: 08.06.2020 të parashtruar nga Xhevdet R.Kryeziu nga fshati Mleqan.

Rrahim Morina: Për këtë kërkesë nga viti 2008 a pas shpallë tenderi dhe fituesi por ajo kompani se ka kryer punën kurrë.

Hashim Vrenezi: Lidhur më një kërkesë që kemi pas me herët ja kemi pas nda 500 euro, por Valoni ja ka leshu mjetet veç 200 euro, me arsyetimin e drejtorit se edhe kryetari ka nxjerrë vendim. Mirë është të kem informacion.

Rrahim Morina: Këtë kërkesë po ja përcjellim kryetarit të Komunës për trajtim? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/189 datë: 12.06.2020 e parashtruar nga z.Endrit Krasniqi nga fshati Lladroviq

Valon Krasniqi: Ky djalë që ka parashtrua kërkesën e di që ka nevojë mi ndihmuar për shkak të gjendjes shëndetësore që ka.

Alban Krasniqi: Ne ndajmë mjete kur ka nevojë konkrete ama me letra të mjekut ose për barna, por jo mi nda mjete kur dikush nuk ka gjendjen e mire psiqike, sepse trajtimin psiqik në nuk mund ta trajtojmë këtu.

Rrahim Morina: Pas propozimit juaj kush jeni që te ja ndajmë 500 euro për trajtim mjekësor? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/193 datë: 15.06.2020 e parashtruar nga z.Besim Maloku nga fshati Pllaqicë

Rrahim Morina: Kush jeni që ta ndihmojmë me 950 euro këtë parashtrues të kërkesës? Unanimisht ishin për.

5. Të ndryshme.

Alban Krasniqi: Disa herë kemi kërkuar që salla e Kuvendit të rregullohen.


Rrahim Morina: Unë kam qenë në Pejë ne Kuvend atje i kam pa nga afër si e kanë sallën te rregulluar dhe si funksionojnë ato pajisje, tani do ti iniciojmë edhe ne procedurat.

Rrahim Morina: Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 16:10

Procesmbajtësi

Naim Avdiqaj jur. i dip



Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina

